



Npi – 01/251 datë: 27.06.2023

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) neni 17 shkronjat (b dhe f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 11, 13 dhe 14.3 shkronja (d) të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, ka prezantuar në Kuvend, Kërkesën Nr.06-350/02-03646/23 dt.06.02.2023 të z.Shefqet Krasniqi – Karaqicë për krijimin e qasjes në rrugë publike përmes pronës Komunale. Zyra e Kryetarit ka bërë Propozimin Nr.02/441 më datën 25.05.2023 me të cilin i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit për hapjen e rrugës publike në një pjesë të N.K. Nr.P-00325-0 me sipërfaqe totale 7566 m<sup>2</sup> në Z.K-Karaqicë, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, miratoi këtë

## V E N D I M

**Për destinimin e pjesës të Ngastrës Kadastrale Nr. P-00325-0 me sipërfaqe prej 153 m<sup>2</sup> në rrugë publike**

### I

**Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më 27.06.2023, me shumicën e votave miratoi Vendimin për Destinimin në Rrugë Publike, pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr. P-00325-0 me sipërfaqe prej 153 m<sup>2</sup> (ku sipas gjendjes në teren rruga do të ketë gjerësin 6 m), në Zonën Kadastrale - Karaqicë, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes.**

### II

Arsyetim: Kuvendi i Komunës, ka vendosur sikurse në dispozitiv duke marrë parasysh edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/241 dt.23.06.2023 pika 5 si dhe propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi me arsyetimin se palës duhet ti ofrohet qasje në rrugën publike përmes pronës komunale me qëllim të ofrimit të mundësisë të shfrytëzimit të pronës për ndërtim ose hipotekë, si dhe me qëllim të stimulimit për kthimin e banorëve të shpërngulur, apo edhe stimulimin e zhvillimit të turizmit malor në këtë zonë të bukur malore të fshatit Karaqicë.

### III

Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

### IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

### V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, dhe Zyrës për Informim



Kryesuesi Kuvendit

Adnan Ademi